

**FJALIMI I PSSP-së CAROLINE ZIADEH NË DEBATIN E KËSHILLIT  
TË SIGURIMIT PËR UNMIK-un**

**Nju Jork**

**23 TETOR 2023**

Zoti President,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Sigurimit,

Shkëlqesi,

Zonja dhe zotërinj:

Jam e nderuar të informoj Këshillin për zhvillimet e fundit kryesore në Kosovë. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm para jush mbulon periudhën prej 19 marsit deri më 18 shtator. Po e filloj fjalimin tim sot duke sjellë në vëmendjen tuaj një incident të rëndë të sigurisë, që ndodhi më 24 shtator në afërsi të fshatit Banjskë të komunës së Zveçanit, në veri të Kosovës.

Herët në mëngjes të asaj dite, një polic i Kosovës u vra dhe dy të tjerë u plagosën në hyrje të fshatit, i cili ishte bllokuar nga dy automjete. Gjatë ditës dhe deri në mbrëmje, Policia e Kosovës dhe elementë të armatosur rëndë u angazhuan në shkëmbime me armë zjarri, duke rezultuar në katër të vdekur dhe

një numër arrestimesh. Policia e Kosovës ka konfiskuar një numër të konsiderueshëm automjesh, pajisje ushtarake dhe armë.

UNMIK-u iu bashkua bashkësisë ndërkombëtare për të dënuar pa mëdyshje incidentin dhe humbjen tragjike të jetëve, duke apeluar për përmbajtje. Është thelbësore që hetimet që po zhvillohen aktualisht të ofrojnë mundësinë për të dokumentuar me fakte këto ngjarje dhe për të kërkuar përgjegjësi nga kryerësit.

Ngjarjet e rënda të 24 shtatorit e përkeqësuan mjedisin tashmë të rënduar të sigurisë, të karakterizuar nga një atmosferë e dyshimit të ndërsjellë dhe perceptimeve kontradiktore që prekin pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht në veri të Kosovës dhe në mesin e komunitetit serb në vende tjera në Kosovë.

Zoti President,

Në ditët, javët madje edhe muajt që çuan në ngjarjet e 24 shtatorit, tensionet politike dhe të sigurisë në veri të Kosovës u rritën në mënyrë të vazhdueshme në mungesë të përparimit të prekshëm në dialogun e mbështetur nga BE-ja. Takimi i nivelit të lartë i mbajtur më 14 shtator në Bruksel nuk solli konsensus mbi renditjen e zbatimit të marrëveshjeve të mëparshme. Kjo ishte sërish një mundësi e humbur për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive drejt një programi

për zbatimin e angazhimeve përkatëse të palëve sipas marrëveshjeve të bëra në Bruksel dhe Ohër në fillim të këtij viti.

Të dyja palët kanë shkëmbyer akuza nxitëse publike, duke dëmtuar kanalet e brishta të komunikimit ndërmjet komuniteteve në Kosovë dhe ndërmjet liderëve politikë në Beograd dhe në Prishtinë. Gjatë kontakteve të mia me një gamë të gjerë bashkëbiseduesish, duke përfshirë liderë komunalë, fetarë, të shoqërisë civile, organizatave dhe drejtues biznesesh, ndjenjat më të zakonshme që kam hasur janë zhgënjimi dhe shqetësimi i shkaktuar nga një e ardhme e pasigurt. Tensionet dhe ankthi në mbarë Kosovën, të raportuara veçanërisht nga pjesëtarët e komunitetit serb, janë nxitur nga retorika politike përçarëse. Në vend se të nxisin tensione përmes mesazheve politike drejtuar një grupi, liderët e zgjedhur duhet të mbajnë përgjegjësi për adresimin e nevojave të sigurisë dhe shqetësimeve më të gjera socio-ekonomike të të gjitha segmenteve të shoqërisë, pavarësisht prejardhjes etnike, gjuhësore apo politike.

Zoti President,

Pengesat si bojkoti nga serbët e Kosovës i zgjedhjeve lokale të 23 prillit në Kosovën veriore, ku ata përbëjnë shumicën e popullsisë, që ngritën çështjen e përfaqësimit adekuat politik, dhe dhuna e tmerrshme më 29 maj që çoi në lëndime të rënda të 93 pjesëtarëve të KFOR-it si dhe të civilëve, paraqesin rreziqe të mëdha për arritjen e paqes dhe stabilitetit afatgjatë. Bllokimi aktual

politik, me ndikim në sigurinë dhe mirëqenien e popullatës, mund të tejkalohet vetëm përmes kompromisit që duhet të arrihet në Dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

Masat për shtensionim janë të rëndësishme thelbësore për zvogëlimin e tensioneve dhe, në këtë aspekt, ndajë shpresat e shumë të tjerëve që rezultati i takimeve të 21 tetorit të udhëhequra nga BE-ja dhe ShBA-ja në Prishtinë dhe Beograd do ta vë dialogun në rrugën përpara, me një përkushtim të qartë të të dyja palëve për zbatimin e masave të shtensionimit dhe të propozimeve të bëra gjatë takimeve. Këtu përfshihet përkushtimi i serishëm i të dyja palëve për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve paraprake të arritura gjatë dialogut. Rrjedhimisht, puna në themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe duhet të fillojë pa vonesë dhe pa parakushte së bashku me të gjitha marrëveshjet e tjera esenciale.

Duhet të kemi parasysh se dështimi i arritjes së kompromisit politik do të vazhdojë të ndikojë negativisht në mirëqenien e njerëzve të zakonshëm, duke përfshirë mundësinë e tyre për të marrë shërbime bazë dhe për të realizuar potencialin e tyre socio-ekonomik. Në këtë drejtim, është thelbësore të theksohet se vonesat në zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut kanë çuar në shtyrjen e një konference donatorësh të BE-së të parashikuar në aneksin e zbatimit të Marrëveshjes së shkurtit, e cila me gjasë do të tërhiqte mbështetje të konsiderueshme ekonomike dhe mundësi investimi.

Zoti President,

Ne kemi folur shpesh gjatë seancave të Këshillit për mënyrat pozitive në të cilat marrëveshjet e qëndrueshme politike ndikojnë në jetën e njerëzve, edhe kur ato kanë një kosto. Ndoshta shumë rrallë flasim për koston edhe më të madhe që rrjedh nga mosarritja e marrëveshjeve. Këtu po flas për koston për të gjitha komunitetet, qofshin ata serbë, shqiptarë apo të tjerë që jetojnë në pjesë të ndryshme të Kosovës dhe të gjithë rajonit.

Tensioni, izolimi dhe mungesa në rritje e besimit të liderët politikë për të adresuar nevojat më urgjente të njerëzve dhe ankesat legjitime të dëshmuara muajt e fundit, dhe më e keqja, përdorimi i dhunës dhe i frikësimit nga njerëz vullnetkeq, kërcënojnë sukseset e arritura me vështirësi përmes dialogut të përkrahur nga BE. Për t'u kthyer në një proces politik më produktiv, kërkohet një udhëheqje e përgjegjshme dhe kompromis.

Ne e dimë thënien se nuk ka zhvillim të qëndrueshëm pa paqe dhe nuk ka paqe pa zhvillim të qëndrueshëm. Prandaj, vlen të theksohet se iniciativat e bashkëpunimit dhe integritit rajonal, në të gjitha format, duhen mirëpritur dhe prioritetizuar për të kontribuar në një dialog më produktiv.

Paqja, prosperiteti, progresi, qëndrueshmëria dhe bashkëpunimi ishin disa nga temat kryesore të theksuara gjatë javës së nivelit të lartë të Asamblesë së

Përgjithshme në shtator, dhe gjatë Samitit të Procesit të Berlinit të mbajtur javën e kaluar në Tiranë. Sot, në këtë organ të lartësuar, besoj se është me rëndësi të madhe që komuniteti ndërkombëtar të kërkojë nga Prishtina dhe Beogradi që të nxisin ndërmarrjen e veprimeve të qëllimshme dhe të bashkërenduara në përputhje me këto prioritet kryesore, duke e bërë të qartë se asnjë lider apo palë nuk mund të presë t'ia dal vetëm në tejkalimin e sfidave aktuale globale.

Zoti President,

Unë e kam theksuar tashmë në deklaratën time të prillit të këtij viti, dhe duhet përsëritur sot, nevojën për komunikim të qartë dhe të vazhdueshëm me publikun për çështje që prekin jetesën e tyre, shëndetin dhe të drejtat e njeriut, çështje të tilla si shpronësimi i tokës dhe liria e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, duke përfshirë edhe përtej vijës kufitare administrative.

Puna e institucioneve të sundimit të ligjit duhet të bazohet në kornizën e të drejtave të njeriut dhe duhet të shpjegohet dhe komunikohet qartë dhe publikisht, për të shmangur keqkuptimet dhe për të siguruar barazinë e të gjithëve para ligjit.

Unë e kam mirëpritur miratimin e ligjit nga Kuvendi i Kosovës, që rregullon procesin e aplikimit për statusin e të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, dhe do të inkurajoja autoritetet që të marrin në konsideratë

rekomandimet e Raportuesit Special të OKB-së për drejtësinë për të vërtetën, dëmshpërblimin dhe garancitë për mospërsëritje. Pas avokimit të vazhdueshëm nga UNMIK-u, agjencitë e OKB-së dhe grupet e shoqërisë civile për përfshirjen e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kushtetutë, ne e mirëpresim vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 1 gushtit të këtij viti, që hap rrugën për përfshirjen e normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara brenda kornizës ligjore të Kosovës.

Zoti President,

Këtë vit ne shënojmë 5 vjetorin e agjendës së UNMIK-ut për ndërtimin e besimit. Pavarësisht historisë së suksesit në forcimin e dialogut, kohezionit social dhe qëndrueshmërisë në nivelin bazë, mjedisi është bërë më sfidues vitin e kaluar. Megjithatë, ne mbetemi fuqishëm të përkushtuar që të vazhdojmë të punojmë me partnerët tanë nga të gjitha komunitetet në Kosovë, për të nxitur komunikimin dhe mirëkuptimin mes njerëzve. Kjo e përgatit terrenin për pranimin e kompromiseve të vështira por thelbësore, të nevojshme për të arritur përparim në dialogun në nivel lidërshipi.

Gjashtë muaj më parë, u hap “Qendra Barabar” me përkrahje të UNMIK-ut dhe komunës së Prishtinës. E përdorur në të dyja gjuhët zyrtare në Kosovë, shqip dhe serbisht, fjala “barabar” do të thotë barazi dhe drejtësi. Qendra është një

hapësirë e sigurt në zemër të Prishtinës, ku njerëzit nga të gjitha sferat e jetës dhe të gjitha komunitetet, mund të takohen për të diskutuar lirshëm dhe për të kapërcyer retorikën politike përçarëse. Që nga hapja e saj në maj të këtij viti, Qendra ka organizuar më shumë se 40 ngjarje multietnike, duke demonstruar se edhe gjatë kohërave sfiduese është e mundur, dhe me të vërtetë e dëshirueshme, të bashkohen njerëzit.

Për të avancuar agjendat e grave dhe të rinjve për paqen dhe sigurinë, Misioni vazhdon të mbështesë organizatat e shoqërisë civile të udhëhequra nga gratë dhe të inkurajojë përfshirjen e të rinjve dhe grave udhëheqëse në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Ne mbështesim iniciativat që synojnë të promovojnë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të grave në proceset politike dhe të integrojnë perspektivat gjinore në procesin e normalizimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Ne gjithashtu do të vazhdojmë të mbështesim të rinjtë, duke përfshirë edhe Asamblenë vjetore të rinisë së OKB-së në Kosovë. Asambleja e 5-të e rinisë u mbajt këtë qershor në kulmin e tensioneve politike. Më shumë se 150 udhëheqës të rinj nga Kosova dhe rajoni u mblodhën dhe trajtuan në mënyrë konstruktive çështje të rëndësishme, duke përfshirë luftimin e dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes, vendimmarrjen e të rinjve dhe ndalimin e dhunës në familje. Falënderojmë Ekipin e OKB-së në Kosovë për bashkëpunimin e ngushtë në këtë drejtim.



Së bashku me partnerët tanë, Misioni siguron qasje të barabartë në drejtësi duke përmirësuar infrastrukturën e sallave të gjyqit, duke ofruar ndihmë juridike dhe përfaqësim falas për më shumë se 2000 persona nga të gjitha komunitetet në mbarë Kosovën, dhe duke ofruar shërbime përkthimi. Ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë.

Dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast për të përgëzuar qëndrueshmërinë e palëve vendore, duke përfshirë partnerët e UNMIK-ut, të grave, burrave dhe të rinjve të përkushtuar nga të gjitha komunitetet e Kosovës, të cilët, përkundër narrativave përçarëse dhe realiteteve sfiduese, punojnë pa u lodhur për të sjellë më shumë mirëkuptim mes komuniteteve të tyre.

Zoti President,

Dëshiroj të ritheksoj mbështetjen e UNMIK-ut për dialogun e përkrahur nga BE-ja, me një ndjenjë urgjence, duke marrë parasysh paqëndrueshmërinë që ka karakterizuar periudhën aktuale të raportimit. Ne jemi të përkushtuar të mbështesim të gjithë zërat që refuzojnë polarizimin në favor të kompromisit dhe bashkëpunimit. Ne do të vazhdojmë punën tonë për ndërtimin e besimit, edhe pse shpesh dëgjojmë se "besimi është në nivelin më të ulët" në këtë moment. Por nëse jo tani, kur?

Më lejoni të them edhe një herë: Dialogu është e vetmja rrugë përpara.

Zoti President,

Përpara mbylljes, do të doja të shfrytëzoj këtë moment për të falënderuar kontributin e jashtëzakonshëm të një prej partnerëve të mi kyç gjatë një periudhe shumë sfiduese në Kosovë, komandantin e KFOR-it në largim, gjeneralmajorin Angelo Michele Ristuccia të Italisë. Udhëheqja e tij ishte e rëndësishme gjatë menaxhimit të disa krizave që shpërthyen gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu i shpreh një mirëseardhje të veçantë pasuesit të tij, gjeneralmajorit Özkan Ulutaş të Turqisë, me të cilin e di se do të gëzojmë një marrëdhënie të ngjashme të afërt pune në përmbushjen e mandatit tonë të përbashkët.

E përfundoj fjalimin duke shprehur mirënjohjen time të thellë për ju, anëtarë të nderuar të Këshillit, për mbështetjen tuaj. Kjo mbështetje është e domosdoshme për punën e vazhdueshme të UNMIK-ut për të ndihmuar në sigurimin e kushteve për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë njerëzit në Kosovë.

Faleminderit shumë.